



Kur të sëmuret fëmija yt

Përmbajtja

Faqja

Infeksionet tek fëmijët e parashkollores 4

Infeksionet e fëmijës dhe imuniteti 4

Antibiotiku 4

Zvogëlo infeksionin në parashkollore 4

Këshilla në rast infeksionesh 5

Ethe/temperaturë 5

Sëmundja e pestë 5

Rrufa/ftohja – rrufë, kollitje, dhembje e fytit 5

Angjinë nga streptokokët 6

Morra 7

Fshikëzat vjeshtore 7

Impetigo – lia (e derrit, e qenit) 7

Sëmundja e barkut 8

Molluskat 8

Fruthi 9

Skarlatina (fruthi i zi) 9

Zgjebe 9

Krimb/skrajë 10

Lia (e bardhë) 10

Inflamacion i syve 11

Pezmatim i veshëve dhe inflamacion i veshëve 11

Kjo broshurë jep informacion prindërve me fëmijë të moshës së parashkollores, mbi sëmundjet më të zakonshme infektuese, që mund të prekë fëmijën, si dhe kur mund të qëndrojë fëmija në parashkollore ose a duhet të qëndrojë fëmija në shtëpi. Broshura bazohet në pasqyrën e njohurive, Infeksionet në parashkollore, të Drejtorisë së çështjeve sociale, nxjerrë në bashkëpunim në mes Mbrojtjes nga infeksionet Skåne, Qendrës së njohurive mbi kujdesin shëndetësor të fëmijëve si dhe mjekut përgjegjës të fëmijëve Percy Nilsson, në Klinikën e fëmijëve në Malmö.

Këshilla

Këshillimorja e kujdesit shëndetësor, me numër të telefonit 1177, mund të jep këshilla mbi sëmundjet, ditën dhe natën. Në uebfaqen e tyre (www.1177.se), mund të lexosh më shumë. Kërko në katorrin e kërkimit në Infeksionet tek fëmijët – udhërrëfyesi i infeksionit (sued. Infektioner hos barn- smittguide) ose në faqet me temat Fëmijët dhe prindërit (sued. Barn och föräldrar). Ti, po ashtu, mund të kontaktosh qendrën shëndetësore ose qendrën e kujdesit shëndetësor të fëmijëve (BVC), ku fëmija është i regjistruar, për të marrë këshilla ose për të caktuar një kohë vizite.

Shpjegim fjalësh mbi infeksionin

Infeksioni – përhapja e një lëndë infektuese, p.sh. virus dhe baktere

Infeksion – sëmundje e shkaktuar nga një lëndë infektuese me komplikime më të lehta deri tek sëmundja serioze

Bartës – të bartësh një lëndë infektuese pa qenë i/e sëmurë

Virus – lëndë infektuese që nuk mund të trajtohet me antibiotik

Baktere – lëndë infektuese që mund të trajtohet me antibiotik

Rezistent ndaj antibiotikut – baktere të qëndrueshme ndaj antibiotikut

Periudha e inkubacionit – koha që nga rasti i infektimit deri te shpërthimi i sëmundjes

Imunitet – pasi që ke pasur një sëmundje ose je vaksinuar, nuk do të sëmurësh nga ajo sëmundje, edhe pse je i/e infektuar.

Infeksionet tek fëmijët e parashkolllores

Infeksionet e fëmijës dhe imuniteti

Infeksionet janë të zakonshme tek fëmijët. Me zhvillimin e imunitetit, infeksionet shërohen më lehtë dhe numri i infeksioneve zvogëlohet. 90% i infeksioneve të fëmijës shkaktohen nga virusi, rrufa/ftohja janë më të zakonshmet. Fëmijët më të vegjël të parashkolllores kanë 6-12 rrufa/ftohje në vit, kurse fëmijët më të rritur kanë 4-6 rrufa/ftohje në vit. Fëmijët, po ashtu, kanë edhe baktere në kanalet e frymëmarrjes. Shumica e tyre janë të dobishme dhe japin një mbrojtje ndaj infeksioneve më të rënda. Si infeksionet ashtu edhe bartja e baktereve, ndihmojnë në forcimin e imunitetit të fëmijës.

Fëmijët kanë reagim të ndryshëm ndaj infeksioneve. Një pjesë e fëmijëve gati nuk kanë asnjë komplikim fare nga një infektion, kurse të tjerët kanë ethe/temperaturë dhe ndjehen të sëmurë. Ndonjëherë, fëmija ka nevojë të pushoj ndonjë ditë në shtëpi, për ta marrë veten e të ketë forcë të merr pjesë në aktivitetet më të zakonshme në parashkolllore.

Antibiotiku

Ndonjëherë, ka nevojë për antibiotik me rastin e trajtimit të infeksionit nga bakteret, por nuk duhet përdorur vend e pa vend. Menjëherë pas një trajtimi me antibiotik, atëherë fëmija është më i ndjeshëm dhe infektohet lehtë, sepse edhe bakteret e dobishme mënjanoen dhe atëherë dobësohet mbrojtja e trupit ndaj infeksioneve të reja. Përveç kësaj, bakteret mund të bëhen rezistent/të qëndrueshme ndaj antibiotikut, dhe kështu behën të paefektshme. **Antibiotiku nuk ka asnjë efekt ndaj virusit.**

Zvogëlo infeksionin në parashkolllore

Shumë infeksione përhapen përmes duarve. Një nga mënyrat më të mira të zvogëlosh përhapjen e infeksionit është të lash duart shpesh. Është mirë t'i mësosh fëmijët të kolliten dhe teshtinin në lak të dorës. Aktivitetet jashtë shtëpisë, po ashtu, zvogëlojnë rrezikun e përhapjes së infeksionit. Qëndrimi jashtë, do të thotë më pak grumbullim të njerëzve dhe doza më të vogla të infektimit. Për të zvogëluar infeksionin, ndonjëherë është me rëndësi që fëmija të rri në shtëpi.

Këshilla në rast infeksionesh

Ethe/temperaturë

Fëmijët kanë ethe nëse temperatura e mëngjesit kalon 38 gradë, ose pas një pushimi gjysmë ore. Fëmijët kanë shpesh ethe, para së gjithash, kur janë të infektuar nga virusi. Ethet nuk janë të rrezikshme, por ato janë një pjesë e mbrojtjes së trupit nga infeksionet.

Vetëmjekimi/kujdesi shëndetësor: Shih si është fëmija dhe lëre fëmijën të vendos vet, sa është i zoti të qëndroj zgjuat/në këmbë. Lëre fëmijën të pi shpesh. Ilaçi për uljen e temperaturës, është, po ashtu, ilaç për zvogëlimin e dhembjeve. Mund të përdoret nëse fëmija dukshëm është keq nga ethet, p.sh. ka dhembje të trupit, është qaraman, han dhe pi më keq, fle keq dhe ka vësh-tirësi të rehatohet në mbrëmje. Kontakto kujdesin shëndetësor nëse fëmija është i ngathët, nuk do të pi, duket i shtangur në qafë, ka ngërçe nga temperatura ose ka temperaturë mbi 41 gradë.

Të jetë në parashkollore apo në shtëpi? Fëmijët me ethe/temperaturë nuk duhet të jenë në parashkollore. Ethet kanë ndikim të ndryshëm tek fëmijët, por një rregull i mirë është të lësh fëmijën në shtëpi edhe një ditë pasi t'i hiqet temperatura.

Sëmundja e pestë

Sëmundja e pestë (infeksion virusi tek fëmijët) fillon me lodhje, dhembje të trupit dhe ethe. Pas disa ditësh skuqen faqet dhe në trup shihen pika të imta të zbehta - kurteshë. Kurteshët mund të dalin dhe hiqen gjatë 1-2 javë. Një pjesë e fëmijëve nuk kanë asnjë komplikim fare. Sëmundja e pestë është një sëmundje e lehtë e virusit e cila është e zakonshme gjatë dimrit dhe pranverës. Koha e inkubacionit është 1-3 javë. Përhapja e infeksionit mund të ndodhë para se të duken kurteshët. Pas sëmundjes, fëmija bëhet imun.

Vetëmjekimi/kujdesi shëndetësor: Ilaçi për uljen e temperaturës dhe qetësimin e dhembjeve mund të zbus (shih pjesën e tekstit me lartë). Rrallëherë ke nevojë të kontaktosh kujdesin shëndetësor.

Të jetë në parashkollore apo në shtëpi? Fëmija duhet të jetë në shtëpi, derisa t'i hiqet temperatura dhe mund të merr pjesë në aktivitetet e zakonshme në parashkollore.

Rrufa/ftohja – rrufë, kollitje, dhembje e fytit

Vanliga Simptoma të zakonshme të ftohjes janë rrufa, kollitja dhe dhembja e fytit. Ky është infeksioni më i zakonshëm i virusit tek fëmijët. Gjatë viteve të parashkollores duhet llogaritur 4-12 ftohjes në vit. Sa më të vegjël janë fëmijët, aq më shumë ftohje do të kenë. Një ftohje zgjat 1-2 javë dhe është më e zakonshme gjatë dimrit. Gjatë këtyre periudhave, fëmija mund të duket se është gjithmonë i sëmurë. Fëmija është i infektuar ndonjë ditë para se të shpërthejë sëmundja, si edhe ditëve të para të sëmundjes. Virus i infekton përmes kollitjes dhe teshtitjeve, si edhe përmes pështymës dhe rrufës që ke në duar. Rreziku i infektimit zvogëlohet, nëse i lanë duart si dhe nëse kollitësh dhe teshtitë në lak të dorës. Koha e inkubacionit është zakonisht 1-3 ditë.

Rrufa

Rrufa (rrjedhja e hundëve) në fillim është e hollë dhe e tejdukshme. Është normale që rrufa trashet dhe bëhet e verdhë ose e gjelbër. Rrufa zakonisht kalon brenda 1-2 javësh. Fëmija nuk ka nevojë të trajtohet me antibiotik ose të rri në shtëpi nga parashkollorja, vetëm pse rrufa është e verdhë ose e gjelbër.

Kolla

Shpesh fillon me kollitje të thatë e cila më vonë bëhet e jargëzuar. Ndonjëherë, me dhembje gërvishtëse në gjoks. Kollitja është një refleks mbrojtës që ndihmon të pastrojë kanalet e frymëmarrjes nga jargët, prandaj edhe nuk duhet pa nevojë të zvogëlosh këtë. Kollitja mund të zgjas 2-4 javë, pra më gjatë se sa rrufa. Kollitja bëhet më e rënduar nëse fëmija vrapon ose luan duke bërë zhurmë.

Dhembja e fytit

Dhembja e fytit/angjinë mund të shkaktohet si nga virusi ashtu edhe nga bakteret. Bajamet që janë thellë në fyt ënjten, skuqen dhe kanë pika të bardha/shtresa. Të dhemb të përpish dhe mund të jetë e vështirë me ngrënë dhe me pi. Ndonjëherë fëmija mund të ketë temperaturë. Angjinë e shkaktohet nga virusi është më e zakonshme tek fëmijët e parashkollorës dhe fëmija ka shpesh në të njëjtën kohë rrufë ose kollë.

Vetëmjekimi/kujdesi shëndetësor: Zbut zëniet e hundëve duke e mbajtur kokën lartë në krevat dhe pika kripe të zier për hundën. Kur ke zënie të rëndë të hundëve, mund të përdorësh pika dhe sprej për hundë. Jargët bëhen më të lehta t'i nxjerrë fëmija duke u kollitur dhe duke pirë rregullisht. Ndonjëherë mund t'i jepen ilaçet për ulje të temperaturës dhe zvogëlimin e dhembjeve (shih Ethet, faqe 5). Kontakto kujdesin nëse fëmija është i lodhur dhe kollitet akoma edhe pas dy javësh. Kontakto kujdesin menjëherë nëse fëmija është i plogësht dhe merr frymë shpejtë, me intervale të shkurtra, ose ka aq dhembje të fytit sa që nuk mund të përpijë pështymën.

Të jetë në parashkollorë apo në shtëpi? Fëmija duhet të jetë në shtëpi, derisa t'i hiqet temperatura dhe mund të merr pjesë në aktivitetet e zakonshme në parashkollorë.

Angjinë nga streptokokët

Angjinë nga streptokokët shkakton ethe dhe dhembje të fytit. Bajamet ënjten, skuqen dhe ndonjëherë bëhen me pika të bardha. Infekton për derisa fëmija është i sëmurë. Përhapet me pikat e pështymës. Koha e inkubacionit është 2-4 ditë. Streptokokët, po ashtu, mund të shkaktojnë impetigo/linë (e dërrit, e qenit), infeksione të plagëve dhe të qenëzave.

Angjinë mund të shkaktohet edhe nga virusi i rrufës/ftohjes. Atëherë fëmija ka edhe probleme të tjera, si rrufë ose kollitje. Angjina e virusit nuk mund të trajtohet me antibiotik.

Vetëmjekimi/kujdesi shëndetësor: Angjina mund të shërohet vetvetiu, brenda një jave. Mund të zbus gjendjen pija e ftohtë ose e ngrohtë. Në rast nevojë, ilaçi për uljen e temperaturës dhe qetësimin e dhembjeve mund të zbus gjendjen (shih Ethet, faqe 5). Nëse nuk ka rënë temperatura për katër ditë, atëherë mund të ketë nevojë për antibiotik. Vlerësimi bëhet në qendrën shëndetësore dhe merret provë e fytit, për të dalluar angjinën e streptokokëve nga ajo e virusit. Kontakto kujdesin menjëherë, nëse fëmija ka aq dhembje të fytit sa që nuk mund të përpijë pështymën.

Të jetë në parashkollore apo në shtëpi? Fëmija duhet të qëndroj në shtëpi për derisa ka dhembje të fytit dhe ka temperaturë. Nëse fëmija merr antibiotik dhe trajtimi këtë vazhduar së paku dy ditë, para se të kthehet fëmija serish në parashkollore. Fëmija duhet të mund merr pjesë në aktivitetet e zakonshme në parashkollore.

Morra

Morrat janë në flokë dhe në rrënjë të flokëve dhe zakonisht shkaktojnë kruarje. Çdokujt mund t'i ndodhë që të ketë morra. Atyre ju pëlqejnë flokët e lara edhe flokët e palara. Infektimi bëhet përmes kontaktit të afërt kokë më kokë gjatë një minute ose edhe me gjatë. Rrallëherë përhapen përmes gjësendit, meqë morrat mbijetojnë, vetëm ndonjë ditë, jashtë rrënjëve të flokëve.

Vetëmjekimi/kujdesi shëndetësor: Vetëm ai/ajo që ka morra duhet të trajtohet. Ilaçe pa recetë ka në barnatore dhe është e rëndësishme të veprosh sipas udhëzimeve. Krihi flokët me krehër morrash disa herë, gjatë dy javësh, për të kontrolluar se a të ka ndihmuar trajtimi. Balsami i flokëve bën që morrat zbulohen më lehtë. Kontrollon gjithë anëtarët e familjes. Rrallëherë ka nevojë të kontaktosh kujdesin shëndetësor.

Të jetë në parashkollore apo në shtëpi? Pas fillimit të trajtimit, fëmija mund të kthehet në parashkollore. Për të penguar përhapjen e morrave, është me rëndësi t'i informosh në parashkollore, ashtu që personeli dhe fëmijët e tjerë, të kontrollohen mos kanë morra.

Fshikëzat vjeshtore


Fshikëzat vjeshtore shkaktojnë ethe dhe fshikëza në gojë që mund të shkaktojnë plagë të dhembshme si dhe kurteshë në shuplakë të duarve dhe në shputa të këmbëve. Disa fëmijë nuk kanë asnjë komplikim fare. Infekzioni kalon vetë pas 7-10 ditëve. Fshikëzat vjeshtore janë një sëmundje e virusit, që është e zakonshme gjatë fundit të verës dhe vjeshtës. Kjo quhet edhe sëmundja e dorës-këmbës- dhe gojës. Koha e inkubacionit është 3-7 ditë. Është më së shumti infektuese ditët e para të sëmundjes. Pas sëmundjes, fëmija zakonisht, bëhet imun.

Vetëmjekimi: Dhembja në gojë mund të jetë e mundimshme. Pija e ftohtë dhe akullorja mund të lehtësojë dhembjet. Në rast nevojë, i jep ilaçe pa recetë, kundër dhembjeve. Rrallëherë ka nevojë të kontaktosh kujdesin shëndetësor.

Të jetë në parashkollore apo në shtëpi? Fëmijët duhet të qëndrojnë në shtëpi, derisa mos të kenë më temperaturë dhe mund të marrin pjesë në aktivitetet e zakonshme në parashkollore.

Impetigo – lia (e derrat, e qenit)

Impetigo është një infeksion i lëkurës. Fillon me flluska të vogla të mbushura me ujë, të cilat rriten, pëlcasin dhe marrin një kore të verdhë dhe të kuqërremtë, rreth e përçark. Kurtshët dalin zakonisht rreth hundës dhe gojës, por mund të dalin edhe në pjesët e tjera të trupit. Impetigo shkaktohet nga bakteret streptokokët dhe stafii lokokët, të cilat janë shumë infektuese. Shërohen zakonisht brenda një jave. Koha e inkubacionit është 2-3 ditë.



Vetëmjekimi/kujdesi shëndetësor: Shërohen më shpejtë nëse i lanë koret (derisa të hiqen). Zbuten koren me një arnë larje të lagur dhe më pas e lanë me sapun dhe ujë. Lajë duart mirë pas kësaj. Kujdesu që fëmija t'i lanë duart shpesh dhe mos të kruhet e mos të prekë plagën. Rrobat e krevatit dhe shtazët kukulla të preferuara mund të ketë nevojë t'i lash. Kontakto kujdesin shëndetësor nëse krijohen fshikëza të mëdha, nëse kurteshët përhapen trupit, ose nëse kjo nuk kalon brenda një jave.

Të jetë në parashkollore apo në shtëpi? Fëmija duhet të qëndroj në shtëpi derisa kurteshët mos të mbledhin më ujë dhe ato të thahen plotësisht. Nëse fëmija merr antibiotik, trajtimi duhet të ketë zgjatur së paku dy ditë dhe kurteshët duhet të jenë të thara, para se të kthehet fëmija në parashkollore.

Sëmundja e barkut

Viruset e sëmundjes së barkut janë shumë infektuese, më të zakonshme janë rotavirusi dhe sëmundja e të vjellave të dimrit. Fillon zakonisht papritmas me vjellje dhe/ose me diarre. Ndonjëherë, fëmija ka edhe temperaturë dhe dhembje të barkut. Vjelljet kalojnë zakonisht pas një dite, ndërsa diarreja zgjatë edhe disa ditë. Koha e inkubacionit është zakonisht 1-3 ditë.

Sëmundja e barkut mund të varet edhe nga bakteret, si salmonella, campylobakter ose EHEC. Kjo është sidomos e zakonshme gjatë verës. Fëmija ka diarre dhe ndonjëherë edhe vjellje, temperaturë dhe dhembje të barkut. Kontrollimi dhe dhënia e provave bëhet në qendrën shëndetësore. Nëse fëmija sëmuret kur ke udhëtuar jashtë shtetit, ose brenda një jave pas kthimit në shtëpi, atëherë kontakto qendrën shëndetësore. Fëmija duhet dhënë provën e jashtëqitjes (nevojës) dhe duhet të qëndrojë në shtëpi derisa të vinë rezultatet e provës.

Vetëmjekimi/kujdesi shëndetësor: Pi shumë pije, preferohet shpesh por në sasi të vogla. Kompensim lëngjesh ka për të blerë ose e përzien vetë atë (1 litër ujë me ½ luge çaji kripë dhe 2 lugë ushqimi sheqer si edhe shtesë eventuale të ndonjë shije). Kontakto me kujdesin shëndetësor nëse fëmija ka shumë diarre dhe jashtëqitja është e përgjakur, kur ka dhembje të forta të barkut ose nëse fëmija duket se ka humbur shumë lëngje, është dukshëm i lodhur dhe i pafuqishëm dhe derdhë ujë pak ose rrallë.

Të jetë në parashkollore apo në shtëpi? Fëmija duhet të qëndroj në shtëpi, së paku një ditë, por preferohet dy ditë, pas vjelljes/diarresë së fundit. Në rast të shpërthimeve të përmasave të mëdha dhe sëmundja e virusit të barkut nuk ndalet dot në parashkollore, mund të ketë nevojë që edhe vëllai/motra e fëmijës të qëndroj në shtëpi.

Molluskat

Molluskat nuk janë të rrezikshme. Mollëza të vogla me ngjyrë lëkure me një gropë të vogël në mes. Zakonisht nuk shkaktojnë asnjë shqetësim. Mund të merr disa muaj ose disa vite, para se të zhduken ato. Shkaktohen nga virusi dhe nuk janë shumë infektuese. Rrallëherë ka nevojë të kontaktosh kujdesin shëndetësor.

Të jetë në parashkollore apo në shtëpi? Fëmija mund të shkoj në parashkollore dhe mund të merr pjesë në të gjitha aktivitetet.

Fruthi

Fruthi fillon me temperaturë të lartë, kollitje të thatë dhe acarim të syve. Pas disa ditësh shihen kurteshë, fillimisht në fytyrë dhe pastaj përhapen në trup. Fëmija është shumë i sëmurë. Koha e inkubacionit është 10-14 ditë. Virusi i fruthit është shumë infektues. Herë pas here ka shpërthime të mëdha të fruthit në botë.



Vaksinimi kundër fruthit përfshihet në programin e vaksinimit të fëmijëve. Një fëmijë i vaksinuar ka imunitet dhe nuk sëmurët. Ai që ka pësuar nga infeksioni, por që nuk e ka pasur sëmundjen ose nuk është i vaksinuar, sëmundja mund të parandalohet nëse masat merren me kohë.

Vetëmjekimi/kujdesi shëndetësor: Ilaçi për uljen e temperaturës dhe qetësimin e dhembjeve mund të zbus gjendjen (shih Ethet, faqe 5). Kontakto gjithmonë kujdesin shëndetësor, por telefono më parë që të marrin nën mbikëqyrje në mënyrë korrekte.

Të jetë në parashkollor apo në shtëpi? Fëmija duhet të qëndroj në shtëpi derisa temperatura dhe kurteshët të hiqen dhe fëmija të mund merr pjesë në aktivitetet e zakonshme në parashkollor.

Skarlatina (fruthi i zi)

Skarlatina shkakton ethe dhe dhembje të fytyrës. Bajamet ënjten dhe skuqen dhe atyre ju dalin pika të bardha, sikurse në rastin e angjinës. Ndonjëherë skuqet gjuha dhe merr një shtresë (ngjyrë të luleshtrydhes së egër). Kurtshët në trup janë pika të vogla dhe të ashpra. Për disa javë lëkura mund të bie (lëvorohet) në shuplakë të duarve dhe shputa të këmbëve. Kjo shkaktohet nga bakteret streptokokë me një materie të veçantë/toksinë e cila shkakton kurteshët. Koha e inkubacionit është 2-4 ditë. Pas sëmundjes fëmija bëhet imun.

Vetëmjekimi/kujdesi shëndetësor: Zbutet me pije të ftohtë ose të ngrohtë. Në rast nevojë përdor ilaç për uljen e temperaturës/ qetësimin e dhembjeve (shih Ethet, faqe 5). Zakonisht trajtohet me antibiotik. Kontakto qendrën shëndetësore.

Të jetë në parashkollor apo në shtëpi? Fëmija duhet të qëndroj në shtëpi derisa ai të mos ketë temperaturë dhe të mund merr pjesë në aktivitetet e zakonshme në parashkollor. Nëse fëmija merr antibiotik, trajtimi duhet të ketë zgjatë së paku 2 ditë, para se të kthehet fëmija në parashkollor.

Zgjebe

Zgjebja shkakton kruarje të madhe e cila zakonisht shfaqet në pjesët e brendshme të kyçeve të dorës, në mes gishtërinjve dhe rreth këmbës, ku lëkura është e hollë dhe e butë. Shkakton skuqe dhe lëkurë të ashpër ose fshikëza dhe ndonjëherë i përngjanë ekzemës. Zgjebja është një shtazë e vogël (e padukshme për syrin e njeriut) e cila infekton vetëm njerëzit. Infekton në rastin e kontaktit trupit me trup, por edhe përmes rrobave ose rrobave të krevatit, ku zgjebja mund të mbijetojë 2-3 ditë. Mund të merr 2-10 javë nga infektimi derisa të filloj kruarja.

Vetëmjekimi/kujdesi shëndetësor: Rekomandohet kontrollimi i mjekut, pasi që është e vështirë të caktohet diagnoza. Edhe ai që ka zgjeben, si edhe anëtarët e tjerë të familjes/njerëzit e shtëpisë, trajtohen njëkohësisht. Rrobat dhe rrobat e krevatit duhet larë. Ilaç pa recetë ka në barnatore. Mund të merr kohë para se të hiqet kruarja.

Të jetë në parashkollore apo në shtëpi? Fëmija duhet të qëndroj në shtëpi një ditë me rastin e trajtimit dhe më pas mund të kthehet në parashkollore. Informo parashkolloren pasi që fëmijët e tjerë dhe të rriturit, po ashtu, mund të kenë nevojë të kontrollohen.

Krimb/skrajë

Krimbi/skraja është 10 mm e gjatë dhe është e hollë si peri dhe është një sëmundje e zakonshme dhe e pa rrezikshme. Fëmija ka kruarje të madhe në prapanicë, para së gjithash në mbrëmje dhe natën, kur krimbi del në grykë të zorrës së trashë dhe bën vezë. Fëmijët infektohen serish nga vezët e krimbit. Mund të merr 3-7 javë nga infektimi deri sa të nis kruarja.

Vetëmjekimi/kujdesi shëndetësor: Trajtohem me ilaçe pa recetë. Pyet në barnatore. Kujdesu që fëmija t'i ketë duart e pastra, me thonj të prerë, ndërro çdo ditë rrobat e brendshme, dhe ndërro shpesh rrobat e krevatit. Kontakto qendrën shëndetësore për fëmije (BVC) ose qendrën shëndetësore, nëse nuk zhiduken problemet.

Të jetë në parashkollore apo në shtëpi? Fëmija nuk ka nevojë të qëndrojë në shtëpi gjatë kohës së trajtimit.

Lia (e bardhë)

Lia fillon me ethe dhe fshikëza që kruhen/lia e cila më vonë thahet. Virusi i lisë është shumë infektues. Ka në mukozat e hundës dhe në grykë dhe infekton qysh më herët, pa u dukur lia. Koha e inkubacionit është 10-20 ditë. Shpesh është më mirë ta kesh linë në moshën e parashkollorës se sa më vonë gjatë jetës. Pas infektimit nga lia, virusi është duke pushuar në trup. Variçella (sued. bältros) është një riaktivizim i virusit tënd të vjetër të virusit të lisë dhe kjo shfaqet, para së gjithash, tek te moshuarit. Lia nuk të infekton që të kesh variçellën, mirëpo variçella mund të infektoj që të kesh linë.

Vetëmjekimi/kujdesi shëndetësor: Dhoma e ftohët dhe ftohja zbutë kruarjen. Ndonjëherë mund t'i jepet ilaç për uljen e temperaturës/qetësimin e dhembjeve (shih Ethet, faqe 5). Shko në qendrën shëndetësore nëse lia bëhet e qullët ose skuqet shumë për rreth, si shenjë e një infeksioni bakteresh.

Të shkosh në parashkollë apo të rrih në shtëpi? Fëmiju duhet të rri në shtëpi derisa lia e bardhë/lia e dhenve të jetë tharë dhe puçrra të reja të mos u dalin më. Fëmiju poashtu duhet të mos vuajë nga ethet/zjarrmia dhe të ketë fuqi të marrë pjesë në aktivitetet e zakonshme. Lia e bardhë/lia e dhenve është tejet ngjithëse dhe mund të infektojë para se puçrrat e lisë së bardhë të paraqiten. Prandaj mund të jetë vështirë që përhapja e infektimit të parandalohet në parashkollë.

Inflamacion i syve

Me rastin e inflamacionit të syve, sytë skuqen dhe krijohet këlbazë/sekrecion në sy. Inflamacioni i syve mund të shkaktohet si nga virusi i rrufës/ftohjes, baktereve dhe alergjisë. Kur kanë rrufë, disa fëmijë kanë virusin e rrufës/ftohjes në kanalet e frymëmarrjes, ndërsa të tjerët kanë virusin edhe në sy. Fëmijës i skuqen sytë me pakëz këlbazë/sekrecion në dhomëzën e syrit, pasi që ka fjetur. Shërohet brenda një jave, pa trajtim. Me rastin e infektimit nga bakteret, syri bëhet plotësisht i ngjitur pas fjetjes dhe shpesh rrjedhë këlbazë e trashë/sekrecion, edhe kur fëmija është i zgjuar. Mund të shërohet duke e larë syrin, por ndonjëherë ka nevojë trajtimi me antibiotik. Alergjia shkakton kruarje, të dy sytë skuqen dhe këlbaza/sekrecioni është i tejdukshëm dhe elastik.

Vetëmjekimi/kujdesi shëndetësor: Laje syrin pastër me ujë të zakonshëm, aq shpesh sa ka nevojë. Përdor një kompresë të butë ose pambuk dhe e lanë nga dhomëza e jashtme e syrit në drejtim të dhomëzës së brendshme. Më pas, i lanë duart me kujdes. Ndërroj shpesh peshqirët dhe këllëfët e jastëkut. Kontakto qendrën shëndetësore nëse fëmija ka telashe të mëdha nga syri, ka dhimbje të syrit ose nëse infeksioni nuk ka kaluar pas një jave.

Të jetë në parashkollore apo në shtëpi? Fëmija mund të qëndrojë në parashkollore nëse ka vetëm pakëz këlbazë/sekrecion në sy, pasi që ka fjetur. Është mirë që fëmija të rri në shtëpi nëse sytë kanë qelb, ngjiten dhe ka nevojë të lash syrin. disa herë në ditë.

Pezmatim i veshëve dhe inflamacion i veshëve

Pezmatimi i veshëve është lloji më i lehtë i inflamacionit të veshëve dhe mund të shfaqet kur ke virusin e rrufës/ftohjes. Lëng i tejdukshëm krijohet pas timpanit dhe ke një ndjenjë shtypje, si t' i vësh kapak veshit. Me rastin e inflamacionit të veshit, lëngu bëhet qelb dhe fëmija mund të ketë dhembje të madhe të veshit. Temperatura me atë rast është e zakonshme.

Vetëmjekimi/kujdesi shëndetësor: Mbaj kokën lartë në jastëk, kjo e zvogëlon të ënjturit në hundë dhe në veshë, dhe ka më pak dhembje. Në rast nevoje, i jep ilaç për uljen e temperaturës/qetësimin e dhembjeve (shih Ethet, faqe 5). Pezmatimi i veshëve shërohet pa ndonjë trajtim. Edhe inflamacioni i veshëve mund të shërohet vetvetiu tek fëmijët e parashkollorës, të cilët përndryshe janë të shëndetshëm. Kontakto qendrën shëndetësore nëse fëmija ka dhembje të veshit, edhe pse i ke dhënë ilaç për qetësimin e dhembjeve, kur ka temperaturë të lartë ose kur i rrjedh lëng nga veshi. Nuk ke nevojë t' i drejtosh kujdesit natën, mundesh pra të presësh deri ditën e nesërme. Kontakto menjëherë kujdesin shëndetësor nëse fëmija është i plogësht, nuk do të pi, është i ënjtur prapa veshit ose e ka qafen e shtangur.



Të jetë në parashkollore apo në shtëpi? Fëmija mund të qëndrojë në shtëpi, derisa t' i kaloj temperatura dhe mund të merr pjesë në aktivitetet e zakonshme në parashkollore.



Utgiven av Smittskydd Skåne

7:e upplagan, juni 2012

Broschyren kan laddas ner samt beställas på www.skane.se/smittskydd

Layout & original: Ann-Christin Jönsson
Omslagsbild: colourbox.com
Tryckeri: Danagård Litho, Ödeshög